

AKTIVITETET E LSHPM

REVY FOLKLORIKE DHE GARA SPORTIVE

Aktivitetet për të cilat pensionistët janë krenarë dhe për të cilat preokupohen, nuk përmbledhen vetëm me raste të datave dhe jubileve, sepse aktivitetet realizohen në mënyrë të vazhdueshme. Dëshmi për atë janë evenimentet e fundit. Gjatë muajit prill dhe maj janë mbajtur tetë revy rajonale të këngëve muzikës dhe valleve. Gjatë ditëve kur u mbajtën këto manifestime të rëndësishme kulturore, ishte festë për të gjitha gjeneratat, më të moshuarit si mbrojtës të trashëgimisë sonë kulturore, ndërsa më të rinjtë ishin krenarë me prindërit e tyre ose gjyshet dhe gjyshërit e tyre që me dëshirë të madhe dhe shpirt të pathyeshëm tentonin të tregonin se kush jemi dhe si jemi. Revytë çdo kund ishin festë edhe për sy edhe për shpirt. Nëpër salla këndonin të gjithë së bashku, këndonin këngën e bashkësisë dhe bashkëjetesës që janë aq të rëndësishme për të gjithë ne.

Tingujt e zurlave dhe daulleve, këngëve dhe valleve të tridhjetë shoqatave anëtare të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë kanë mbushur sallën e Shtëpisë së Armatës së Maqedonisë më 5 qershor të vitit 2018. Morën pjesë 30, ndërsa kanë mundur të marrin pjesë të gjitha 49, sepse të gjitha ishin të mira, të gjitha tentuan të jenë sa më të mirë, në kufij të mundësive të tyre. Në sallë thua se nuk kishte vend të zbrazët, ashtu sikurse nuk kishte njerëz indiferent. Këngët ngjallnin kujtimet nga rinia, zemrat kërcenin me ritmin e pensionistëve të argëtuar, të cilët me dëshirën që të luajnë sa më mirë vallen e vendit të tyre ose të këndojnë këngën e zgjedhur, haronin vitet dhe problemet që kishin. Përziheshin ndjenjat e krenarisë për rrënjët e tyre, krenari që bota na njeh pikërisht për nga



bukuria dhe originaliteti i folklorit të Maqedonisë, për nga këngët dhe vallet që janë gjurmë shekullore të identitetit dhe sfidës sonë. Krenari, se edhe pse jemi vend i vogël, kemi pasuri kulturore, me të cilën rrallë kush mund të mburret në botë. Historia e të gjithëve që jetojnë në vendin tonë, është shënuar nëpër këngë, në traditat, në pasurinë tonë të pasur kulturore ku janë thurur identiteti dhe tradita e shoqërisë sonë multikulturore. Në këto vende është arritur të mbahet bashkëjetesa, sepse fqinji dhe miku ka qenë po aq të rëndësishëm sa edhe fare-

fisi, pavarësisht fesë, gjuhës ose kombit. Rrespekti ndaj njëri-tjetrit ka qenë udhërrëfyesin ynë në të kaluarën, shembull për gjeneratat që vijjnë. Në revy të gjithë pjesëmarrësit, të gjitha interpretimet janë shpërblyer me duartrokitje të gjata, ndërsa me disa interpretues kanë kënduar edhe të pranishmit në sallë. Revyja e tetë me radhë republikane e këngëve, muzikës dhe valleve është një ngjarje e paharuar e cila gjatë do të rrefehet dhe do t'ua mbushë ditët pensionistëve me përballje të bukura, megjithatë më të lumtur do të jenë ata të cilët

do të përfaqësojnë Lidhjen dhe vendin tonë në Festivalin e 18 ndërkombëtar të stinës së tretë të moshës në muajin shtator në Lubjanë, Republika e Sllovenisë. Revyja e tetë republikane përfundoi me këngën "Maqedonia është e gjitha që e kemi". Duartrokitjet e fuqishme ishin portesia nga ana e pensionistëve.

Por, vallja nuk do të kishte mundur të luhet, kënga nuk kishte mundur të këndohet aq fuqishëm dhe bukur, dhe instrumentet nuk do të kishin mundur të japin tingullin e duhur pa shëndetin dhe kondicionin. Prandaj, pensionistët anëtarë të shoqatave, vëmendje të posaçme i japin sportit dhe aktiviteteve fizike. Shumë sportistë cilësor janë edhe vallëtarë të shkëlqyeshëm edhe në Kumanovë edhe në Ohër, edhe në Demir Hisar... Në muajin prill, maj dhe qershor u mbajtën edhe garat e 23 sportive në tetë rajone. Nderin për të qenë nikoqirë patën shoqatat: Taftalixhe, Qendër, Strumicë, Manastir, Demir Kapi, Kratovë, Vevčan dhe Koçan. Në të gjitha qytetet, në atmosferë të këndshme, fituan më të mirët, më të përgatiturit dhe ata të cilët patën

më shumë fat. Tlë gjithë tentuan të tregojnë rezultate më të mira edhe krahas viteve dhe të plasohen për "Olimpiadën" në muajin shtator, ndërsa gjithëkund në përgjithësi fitues në shoqërim ishin të gjithë. Në të gjitha rajonet të pranishmit u përshëndetën në emër të organizatorit të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë nga ana e nënkryetarit të KE të LSHPM, Salltir Karovski ose nga sekretari i KE të Lidhjes, Stanka Trajkova, si dhe nga përfaqësuesit e Vetëqeverisjes lokale. Edhe përkundër motit të nxehtë, pensionistët kanë garuar dhe kanë dhënë më të mirën prej tyre me qëllim që të marrin pjesë në Olimpiadën sportive të pensionistëve 2018 që do të mbahet në fillim të muajit shtator të këtij viti në Radovish.

Këto ishin dy aktivitetet kryesore të Lidhjes për vitin 2018, ndërsa kishte edhe shumë të tjera. Megjithatë Revytë folklorike dhe garat sportive ishin ngjarjet më masovike dhe më të rëndësishme dhe manifestime që kanë preokupuar anëtarët e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. (Kalina S. Andonova)

SHOQATA E PENSIONISTËVE KOMUNA E SARAJIT

Ndihma për pensionistët me pensione të ulëta

Shoqata e pensionistëve e Komunës së Sarajit, në kuadër të programit për punë, edhe përkundër mundësive të kufizuara financiare, edhe këtë vit ka dhënë një ndihmë modeste për pensionistët me pensione të ulëta – anëtarë të Shoqatës. Komisioni për shëndet dhe çështje sociale i udhëhequr nga Dr. Jovan Deçkov, 30 pensionistëve të kategorisë së theksuar u ka ndarë pako me artikuj ushqimor dhe mjete higjienike. Vlera e pakos ishte 1.500 denarë. Për këtë kategori

të pensionistëve, Shoqata ka kërkuar ndihmë nga biznesmenë me çka ka siguruar pako me prodhime të mishit nga donatorë të territorit të komunës: "Uka-Komerc", "Demokracija" dhe "Tiamo". Edhe Kryqi i Kuq i qytetit, pensionistëve të Shoqatës u ka ndarë 30 pako për kategorinë e theksuar.

Gjithsesi se me këtë ndihmë Shoqata nuk ka zgjidhur problemin e kësaj kategorie të pensionistëve, por megjithatë ka zbutur deri diku nevojat e tyre.

